

LIGJ
Nr.10 018, datë 13.11.2008

PËR AVOKATURËN E SHTETIT¹

(Ndryshuar me ligjin nr. 86/2018, datë 22.11.2018, nr. 91/2023, datë 2.11.2023; nr. 85/2026, datë 23.7.2026)

(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave për organizimin dhe funksionimin e Avokaturës së Shtetit.

Neni 2

Avokatura e Shtetit

(Ndryshuar pika 1, 2 dhe 4 me ligjin nr. 86/2018, datë 22.11.2018)

1. Avokatura e Shtetit është person juridik publik, në varësi të Kryeministrit, me seli në Tiranë.

2. Avokatura e Shtetit është institucion qendror i administratës publike, i ngarkuar ekskluzivisht për dhënien e asistencës juridike. Asistenca juridike përfshin shërbimin këshillimor dhe të përfaqësimit dhe jepet ekskluzivisht nga avokatët e shtetit për personat juridikë dhe sipas funksioneve të përcaktuara në nenin 5 të këtij ligji.

3. Avokatura e Shtetit organizohet dhe e ushtron veprimtarinë sipas përcaktimeve të këtij ligji.

4. Avokatura e Shtetit financohet nga buxheti i shtetit dhe nga burime të tjera të ligjshme.

Neni 3

Parimet e veprimtarisë së Avokaturës së Shtetit

(Shtuar fjalë me ligjin nr. 86/2018, datë 22.11.2018)

¹ Ligji nr.10 018, datë 13.11.2008 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 176, datë 26 nëntor 2008.
Ligji nr. 86/2018, datë 22.11.2018 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 177, datë 14dhjetor 2018.

Avokatura e Shtetit e ushtron veprimtarinë në bazë të parimeve të profesionalizmit, të eficiencës, të konfidencialitetit, të unitetit të doktrinës, të përgjegjësisë dhe korrektësisë në zbatimin e legjislacionit në fuqi.

KREU II ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I AVOKATURËS SË SHTETIT

Neni 4

Organizimi i Avokaturës së Shtetit

(Shtuar shkronja “d” e pikës 1, shtuar fjalë në pikën 3 dhe 5, shfuqizuar pika 6 dhe ndryshuar pika 7, me ligjin nr. 86/2018, datë 22.11.2018, ndryshuar shkronja “a” e pikës 3 me ligjin nr. 91/2023, datë 2.11.2023; hequr togfjalësh në shkronjën “b” të pikës 3 dhe ndryshuar pika 4 me ligjin nr. 85/2026, datë 23.7.2026)

1. Avokatura e Shtetit drejtohet nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit dhe organizohet në dy nivele, në nivel qendror dhe vendor.
2. Avokatura e Shtetit në nivel qendror përbëhet nga:
 - a) zyra e përfaqësimit ligjor në gjykatat kombëtare;
 - b) zyra e këshillimit dhe koordinimit ndërministror;
 - c) zyra e përfaqësimit në gjykatat e huaja, ndërkombëtare dhe në arbitrazhin ndërkombëtar;
 - ç) zyra e inspektimit;
 - d) Kolegji i Avokaturës së Shtetit.
3. Avokatura e Shtetit në nivel vendor përbëhet nga:
 - a) zyrat vendore;
 - b) avokatët e shtetit pranë ministrive.
4. Avokatura e Shtetit ka në përbërjen e saj ndihmësit ligjorë të avokatëve të shtetit dhe administratën mbështetëse. Marrëdhëniet juridike të punës së ndihmësve ligjorë të avokatëve të shtetit rregullohen sipas dispozitave të këtij ligji dhe të Kodit të Punës. Marrëdhëniet e punës së punonjësve të administratës mbështetëse rregullohen sipas legjislacionit në fuqi për marrëdhëniet e punës.
5. Struktura dhe organika e Avokaturës së Shtetit miratohen me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit.
6. Shfuqizuar.
7. Marrëdhëniet ndërmjet Avokaturës së Shtetit dhe personave juridikë, të përcaktuar në nenin 5, të këtij ligji, roli i avokatit të shtetit në gjykim, si edhe normat procedurale të posaçme përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 5

Funksionet e Avokaturës së Shtetit

(Ndryshuar fjalë në shkronjën “a” të pikës 1, shtuar shkronja “f”, shtuar pika 1/1, shtuar shkronja “ç” në pikën 2, me ligjin nr. 86/2018, datë 22.11.2018; ndryshuar shkronja “c” e pikës 1 dhe hequr togfjalësh në shkronjën “b” dhe “c” të pikës 2 me ligjin nr. 85/2026, datë 23.7.2026)

1. Avokatura e Shtetit kryen funksionet e mëposhtme:

a) ofron shërbim këshillimor për veprimtarinë juridike të personave juridikë të parashikuar në këtë nen, veçanërisht për lidhjen e kontratave, të cilat parashikojnë efekte financiare për shtetin;

b) përfaqëson dhe mbron interesat pasurorë të shtetit shqiptar pranë gjykatave kombëtare, ndërkombëtare dhe të huaja, pa autorizim të posaçëm të të përfaqësuarit në çështjet gjyqësore, në të cilat një organ i administratës shtetërore ose Republika e Shqipërisë është palë. Në çështje të veçanta, sipas kriterëve lëndore dhe sasiore, të përcaktuara në rregulloren e miratuar nga Këshilli i Ministrave, Avokati i Përgjithshëm i Shtetit mund t'ia delegojë të drejtën e përfaqësimit dhe të mbrojtjes organit të interesuar të administratës;

c) përfaqëson dhe mbron interesat pasurorë të organeve të vetëqeverisjes vendore përpara gjykatave të të gjitha niveleve, pa autorizim të posaçëm të të përfaqësuarit në çështjet gjyqësore, në të cilat këto organe janë palë. Në çështje të veçanta, sipas kriterëve lëndore dhe sasiore, të përcaktuara në rregulloren e miratuar nga Këshilli i Ministrave, Avokati i Përgjithshëm i Shtetit mund t'ia delegojë të drejtën e përfaqësimit dhe të mbrojtjes organit të interesuar të vetëqeverisjes vendore;

ç) bashkërendon punën me prokurorinë për mbrojtjen, në gjykim, të interesave të shtetit për çështjet civile, zgjidhja e të cilave bëhet gjatë një procesi penal;

d) përcakton rregulla për unifikimin e praktikave dhe formulimin e kriterëve të përgjithshme të asistencës juridike të shtetit;

dh) ndërmjetëson për zgjidhjen me pajtim të mosmarrëveshjeve ndërmjet organeve qendrore të administratës publike dhe enteve publike;

e) ka të drejtën e nisjes së veprimeve ligjore, me qëllim për të shfuqizuar aktet juridike dhe kontratat administrative, si edhe për rishikimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, në pajtim me kushtet dhe kriteret e parashikuara në ligjin procedural dhe në këtë ligj, me autorizim paraprak të organit administrativ të interesuar, me përjashtim të rasteve të urgjencës;

ë) ka të drejtë të ngrejë padi, me objekt shpërblimin e dëmit të shkaktuar interesave pasurorë të shtetit, me autorizimin e organit shtetëror përkatës, me përjashtim të rasteve të urgjencës.

f) mbi bazën e kërkesës së Kryeministrit, jep mendim për projektakte që lidhen me veprimtarinë e organeve të administratës publike.

1/1. Avokatura e Shtetit ofron asistencë juridike, sipas parashikimeve të këtij ligji, për personat juridikë të mëposhtëm:

a) institucionet shtetërore;

b) entet publike;

c) shoqëritë e krijuara ose që veprojnë sipas ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, ku aksioneri shtetëror ka të drejtë të emërojë shumicën e anëtarëve të organeve drejtuese të shoqërisë ose zotëron më shumë se gjysmën e aksioneve apo kuotave.

Personi juridik bashkëpunon me avokatin e shtetit dhe merr pjesë në procesin gjyqësor, në të cilin është palë ndërgjyqëse. Personi juridik vë në dispozicion të avokatit të shtetit çdo informacion të dhënë, apo dokumentacion që disponon, si dhe qëndrimin e tij me shkrim mbi çështjen në gjykim. Avokati i shtetit, në cilësinë të përfaqësuesit ligjor të personit juridik, vendos lidhur me qëndrimin dhe mbrojtjen e çështjes, si dhe bën përfaqësimin në gjykim.

2. Avokatura e Shtetit nuk jep asistencë juridike:

- a) në çështjet gjyqësore ndërmjet organeve qendrore të administratës publike;
- b) në çështjet gjyqësore ndërmjet organeve të qeverisjes vendore;
- c) në çështjet gjyqësore ndërmjet organeve qendrore të administratës publike dhe organeve të qeverisjes vendore, për organet e qeverisjes vendore.
- ç) për hartimin e akteve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të së drejtës publike dhe çështjeve gjyqësore që lidhen me këto procese, përveç kur parashikohet ndryshe në këtë ligj.

Neni 6

Avokati i Përgjithshëm i Shtetit

(Ndryshuar fjalë në pikat “ë”, “g” dhe “gj”, ndryshuar shkronja “h” dhe shtuar shkronja “k”, me ligjin nr. 86/2018, datë 22.11.2018)

Avokati i Përgjithshëm i Shtetit ushtron këto kompetenca:

- a) drejton, organizon dhe mbikëqyr veprimtarinë e institucionit dhe është përgjegjës për mirëfunksionimin e tij;
- b) përfaqëson institucionin në marrëdhëniet me të tretët;
- c) përcakton ndarjen e çështjeve gjyqësore dhe të kërkesave për dhënie mendimi me shkrim në të dyja nivelet;
- ç) jep udhëzime të brendshme për trajtimin e çështjeve gjyqësore apo të këshillimeve ligjore;
- d) miraton rregulla të posaçme për unifikimin e praktikave të këshillimit, përfaqësimit dhe ndërmjetësimit, të ndjekura nga avokatët e shtetit;
- dh) shqyrton dhe vendos për kërkesat e avokatëve të shtetit në të dyja nivelet, për ushtrimin e funksioneve të tyre ligjore;
- e) urdhëron kryerjen e inspektimeve në të dyja nivelet e Avokaturës së Shtetit;
- ë) i raporton Kryeministrit, jo më pak se një herë në muaj, për veprimtarinë e kryer nga Avokatura e Shtetit, duke vënë në dukje mangësitë e mundshme ligjore dhe nevojat për ndryshime përkatëse;
- f) i paraqet një raport vjetor Këshillit të Ministrave për dëmin e shkaktuar ndaj interesave publikë nga veprimet e organeve të administratës publike, të konstatuara gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij;
- g) i raporton Kryeministrit, me kërkesë të këtij të fundit ose me nismën e vet, për çështje të veçanta, për të cilat ka marrë dijeni para dhe gjatë përfaqësimit të mbrojtjes së interesave shtetërorë;
- gj) i propozon Kryeministrit ndërmarrjen e nismave ligjore për plotësimin dhe përmirësimin e kuadrit ligjor në fuqi;
- h) përfaqëson, për shkak të detyrës, Republikën e Shqipërisë në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e agjentit qeveritar.
- i) në raste të veçanta, përfaqëson vetë institucionin para gjykatave kombëtare dhe ndërkombëtare;
- j) planifikon dhe administron buxhetin vjetor të Avokaturës së Shtetit.
- k) miraton rregulloren e brendshme të funksionimit të Avokaturës së Shtetit.

KREU III

AVOKATURA E SHTETIT NË NIVEL QENDROR

Neni 7

Zyra e përfaqësimit ligjor në gjykatat kombëtare

1. Zyra e përfaqësimit ligjor në gjykatat kombëtare është struktura në nivel qendror, përgjegjëse për përfaqësimin e interesave pasurorë të shtetit pranë Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese. Në raste të veçanta, me urdhër të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, avokatët e shtetit të këtij sektori kryejnë përfaqësimin edhe pranë gjykatave të tjera kombëtare.

2. Zyra e përfaqësimit ligjor në gjykatat kombëtare përbëhet nga avokatë të shtetit dhe drejtohet nga njëri prej tyre, i emëruar sipas parashikimeve të nenit 21 të këtij ligji.

3. Detyrat e kësaj zyre, në ushtrimin e kompetencave që i jep ligji, si dhe mënyra e kryerjes së tyre, përcaktohen në rregulloren e brendshme të funksionimit të Avokaturës së Shtetit.

Neni 8

Zyra e këshillimit dhe koordinimit ndërministror

1. Zyra e këshillimit dhe koordinimit ndërministror është struktura përgjegjëse për ushtrimin e funksionit këshillimor të Avokaturës së Shtetit për bashkërendimin e punës dhe mbikëqyrjen e avokatëve të shtetit pranë ministrive, për funksionet e tyre këshillimore.

2. Zyra e këshillimit dhe koordinimit ndërministror përbëhet nga avokatë të shtetit dhe drejtohet nga njëri prej tyre, i emëruar sipas parashikimeve të nenit 21 të këtij ligji.

3. Detyrat e kësaj zyre, në ushtrimin e kompetencave që i jep ligji, si dhe mënyra e kryerjes së tyre, përcaktohen në rregulloren e brendshme të funksionimit të Avokaturës së Shtetit.

Neni 9

Zyra e përfaqësimit në gjykatat e huaja, ndërkombëtare dhe në arbitrazhin ndërkombëtar

(Ndryshuar fjalia e dytë e pikes 2, pika 3, 4 dhe shtuar pika 5/1 me ligjin nr. 86/2018, datë 22.11.2018; ndryshuar pika 4 dhe hequr togfjalësh në pikën 5 me ligjin nr. 85/2026, datë 23.7.2026)

1. Përfaqësimi dhe mbrojtja e interesave të shtetit shqiptar pranë gjykatave të huaja dhe organizmave ndërkombëtarë, me karakter gjyqësor apo mbikëqyrës, kryhen nga Avokatura e Shtetit, nëpërmjet zyrës së përfaqësimit në gjykatat e huaja, ndërkombëtare dhe në arbitrazhin ndërkombëtar.

2. Kjo zyrë përbëhet nga avokatë të shtetit dhe drejtohet nga njëri prej tyre, i emëruar sipas parashikimeve të nenit 21 të këtij ligji. Njëri ose disa prej avokatëve të shtetit të kësaj zyre emërohen nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit, si përfaqësues ligjorë të Republikës së Shqipërisë në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në rolin e bashkagjentëve.

3. Avokati i Përgjithshëm i Shtetit, apo përfaqësuesit e Republikës së Shqipërisë si bashkagjentë, gjatë ushtrimit të funksionit të agjentit të Qeverisë Shqiptare, pranë Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ndihmohen nga juristë.

4. Pranë misionit të përhershëm të Republikës së Shqipërisë në Këshillin e Evropës, Avokati i Përgjithshëm i Shtetit cakton një ose disa avokatë shteti si përfaqësues të përhershëm dhe që veprojnë në emër të tij pranë Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

5. Juristët, të cilët veprojnë pranë kësaj zyre, gëzojnë statusin e nëpunësit civil dhe emërohen në detyrë sipas legjislacionit në fuqi për nëpunësin civil.

5/1. Në rast arbitrazhi ndërkombëtar në fushën e investimeve, ku palë është Republika e Shqipërisë, organi i interesuar, sipas këtij ligji, konsiderohet ministria përgjegjëse, e cila mbulon shpenzimet e nevojshme për përfaqësimin dhe mbrojtjen e interesave të Republikës së Shqipërisë. Kur kjo nuk mund të identifikohet, organi i interesuar konsiderohet ministria përgjegjëse për investimet e huaja.

6. Detyrat e kësaj zyre, në ushtrimin e kompetencave që i jep ligji, si dhe mënyra e kryerjes së tyre përcaktohen në rregulloren e brendshme të funksionimit të Avokaturës së Shtetit.

Neni 10

Zyra e inspektimit

1. Zyra e inspektimit është struktura në nivel qendror, përgjegjëse për kryerjen e kontrollit të veprimtarisë së avokatëve të shtetit, në të dyja nivelet e organizimit, si dhe kryerjen e funksioneve mbështetëse, në rastet kur vihen re pamjaftueshmëri në burime, materiale dhe njerëzore, për ushtrimin me efektivitet të funksioneve të institucionit.

2. Zyra e inspektimit përbëhet nga avokatë të shtetit dhe drejtohet nga njëri prej tyre, i emëruar sipas parashikimeve të nenit 21 të këtij ligji.

3. Detyrat e kësaj zyre, në ushtrimin e kompetencave që i jep ligji, si dhe mënyra e kryerjes së tyre përcaktohen në rregulloren e brendshme të funksionimit të Avokaturës së Shtetit.

Neni 10/1

Kolegji i Avokaturës së Shtetit

(Shtuar me ligjin nr. 86/2018, datë 22.11.2018)

1. Kolegji i Avokaturës së Shtetit përbëhet nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit, i cili kryeson kolegjin, si dhe nga gjashtë avokatë të shtetit, të zgjedhur për dy vjet nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit.

2. Kolegji i Avokaturës së Shtetit ushtron këto detyra:

a) jep këshilla për çështje të një rëndësie të veçantë për interesat e shtetit dhe miraton strategji të mbrojtjes për këto raste;

b) jep udhëzime të përgjithshme për bashkërendimin dhe trajtimin e çështjeve, në kuadër të dhënies së asistencës juridike;

c) zgjidh, pasi ka dëgjuar të interesuarit, papajtueshmëritë e opinioneve që lindin në trajtimin e çështjeve gjyqësore në proces dhe këshillimeve, ndërmjet avokatëve që ushtrojnë funksione drejtuese dhe atyre të ngarkuar me ndjekjen e çështjeve;

ç) ushtron çdo detyrë tjetër të parashikuar në këtë ligj.

3. Mbledhjet e Kolegjit të Avokaturës së Shtetit janë të vlefshme kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve, me përjashtim të rasteve kur Avokati i Përgjithshëm i Shtetit,

për shkak të rëndësisë së çështjes, kërkon që në mbledhje të jenë të pranishëm të gjithë anëtarët e kolegjit. Një nga anëtarët e kolegjit zgjidhet relator për çështjen. Në mbledhjet e kolegjit mund të thirret për të dhënë shpjegime avokati i shtetit i ngarkuar me çështjen që do të shqyrtohet.

4. Me kërkesën e Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, kur vlerësohet e nevojshme, kolegji mund të ftojë përfaqësues të personave juridikë, të parashikuar në nenin 5, të këtij ligji, të cilët marrin pjesë pa të drejtë vote.

5. Vendimet e Kolegjit të Avokaturës së Shtetit miratohen me shumicën e anëtarëve dhe janë detyruese për avokatët e shtetit. Në rast barazie të votave, vota e kryetarit është vendimtare.

6. Kriteret, procedura e përzgjedhjes së anëtarëve të Kolegjit të Avokaturës së Shtetit, si dhe rregulla të hollësishme për organizimin dhe funksionimin e tij përcaktohen në rregulloren e brendshme të funksionimit të Avokaturës së Shtetit.

KREU IV AVOKATURA E SHTETIT NË NIVEL VENDOR

Neni 11

Zyrat vendore në Avokaturën e Shtetit

(Ndryshuar fjalë në pikën 1 dhe 6 me ligjin nr. 86/2018, datë 22.11.2018, ndryshuar titulli i nenit, ndryshuar pika 1, shtuar pikat 1.1-1.5, hequr fjalë në pikën 2 me ligjin nr. 91/2023, datë 2.11.2023)

1. Zyrat vendore të Avokaturës së Shtetit janë përgjegjëse për dhënien e asistencës juridike personave juridikë të përcaktuar në nenin 5 të këtij ligji.

1.1 Avokati i Përgjithshëm i Shtetit bën vlerësimin e organizimit të zyrave vendore pas çdo ndryshimi në organizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave nga organet përgjegjëse sipas legjislacionit në fuqi.

1.2 Zyrat vendore i shtrijnë kompetencat e tyre tokësore pranë një ose më shumë gjykatave të shkallës së parë, me afërsi territoriale ndërmjet tyre, si dhe pranë gjykatave të apelit.

1.3 Zyrat vendore dhe kompetencat e tyre tokësore caktohen duke marrë parasysh, në mënyrë të njëjtë dhe të përshtatshme, kriteret e mëposhtme:

a) organizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencat tokësore të gjykatave;

b) ngarkesën e punës në lidhje me çështjet e ardhura, të përfunduara dhe në shqyrtim, si dhe burimet njerëzore në dispozicion.

1.4 Avokati i Përgjithshëm i Shtetit njofton Kryeministrin për nevojat e riorganizimit të zyrave vendore në bazë të vlerësimit të kryer sipas pikës 1.2 dhe pikës 1.3 të këtij neni.

1.5 Këshilli i Ministrave, me propozimin e Kryeministrit, miraton organizimin e zyrave vendore.

2. Zyrat vendore përbëhen nga avokatë të shtetit dhe drejtohen nga njëri prej tyre, i emëruar sipas parashikimeve të nenit 21 të këtij ligji.

3. Funksioni i drejtuesit të zyrës vendore, e cila ka në organikën e saj vetëm një avokat shteti, kryhet nga ky avokat.

4. Rastet e konfliktit të kompetencave territoriale ndërmjet zyrave vendore zgjidhen nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit.

5. Detyrat e kësaj zyre, në ushtrimin e kompetencave që i jep ligji, si dhe mënyra e kryerjes së tyre përcaktohen në rregulloren e brendshme të funksionimit të Avokaturës së Shtetit.

6. Këshilli i Ministrave siguron dhe garanton mirëfunksionimin e zyrave vendore në mjedise shtetërore.

Neni 12

Avokatët e Shtetit pranë ministrive

(Ndryshuar tituli, pika 1, 3, ndryshuar fjalë në pikën 5 dhe 6, shfuqizuar pika 4 dhe 7 me ligjin nr. 86/2018, datë 22.11.2018; ndryshuar titulli, togfjalësh në pikën 1 dhe hequr togfjalësh në pikën 3 me ligjin nr. 85/2026, datë 23.7.2026)

1. Pranë ministrive veprojnë një ose disa avokatë shteti, të cilët ushtrojnë funksione këshillimore dhe përfaqësimi, sipas parashikimeve të këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

2. Funksioni i përfaqësimit dhe mbrojtjes në gjyq të interesave të institucioneve, pranë të cilave veprojnë avokatët e shtetit, ushtrohet prej tyre në rastet dhe çështjet e përcaktuara në rregulloren e miratuar nga Këshilli i Ministrave.

3. Avokatët e shtetit pranë ministrive kanë varësi administrative dhe funksionale nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit.

4. Shfuqizuar.

5. Funksioni këshillimor i avokatit të shtetit pranë ministrive sipas parashikimeve të këtij ligji realizohet nëpërmjet pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë ose të tërthortë të tij në hartimin e akteve juridike të institucionit, pranë të cilit ai vepron dhe të institucioneve të varësisë, që sjellin pasoja juridike me karakter financiar për shtetin.

6. Mënyra e bashkërendimit të punës së avokatëve të shtetit pranë ministrive me strukturat juridiko-profesionale të këtyre institucioneve dhe raportet ndërmjet Avokaturës së Shtetit dhe titullarëve të ministrive përcaktohen në rregulloren e miratuar nga Këshilli i Ministrave.

7. Shfuqizuar.

Neni 12/1

Ndihmësi ligjor i avokatëve të shtetit

(Shtuar me ligjin nr. 85/2026, datë 23.7.2026)

1. Ndihmësi ligjor i avokatëve të shtetit emërohet nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit, në nivel qendror dhe vendor, në bazë të parimit të shanseve të barabarta, meritës e profesionalizmit, nëpërmjet procedurave përzgjedhëse, sipas strukturës dhe organikës së Avokaturës së Shtetit, të miratuar me urdhër të Kryeministrit.

2. Ndihmës ligjor i avokatit të shtetit emërohet personi që plotëson kriteret e mëposhtme:

a) të jetë shtetas shqiptar;

b) të ketë përfunduar programin e ciklit të dytë të studimeve universitare për drejtësi me diplomë “Master i shkencave” brenda vendit ose diplomë të njësuar me të apo të ketë

përfunduar studimet universitare për drejtësi jashtë vendit, të njohur dhe të njësuar sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë;

c) të ketë jo më pak se 1 (një) vit përvojë pune në fushën juridike;

ç) të mos jetë dënuar me vendim gjykate të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;

d) të mos jetë larguar nga shërbimi civil apo çdo funksion tjetër publik për shkelje ose paaftësi në kryerjen e detyrave;

dh) të ketë zotësi të plotë për të vepruar.

3. Avokati i Përgjithshëm i Shtetit cakton ndihmësin ligjor të avokatit të shtetit pranë një ose disa avokatëve të shtetit.

4. Ndihmësi ligjor i avokatit të shtetit analizon praktikën gjyqësore përkatëse për interpretimin e dispozitave të zbatueshme për çështjet në gjykim, përpunon çështjen dhe përgatit mbrojtje të thjeshta standarde me shkallë kompleksiteti të ulët për përfaqësimin dhe mbrojtjen nga avokati i shtetit, kryen detyra të tjera për hetimin administrativ dhe përpunimin e çështjes, siç kërkohet nga avokati i shtetit. Rregullat specifike, të drejtat dhe detyrat e ndihmësit ligjor të avokatit të shtetit përcaktohen me urdhër të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit.

5. Rregulla më të hollësishme për procedurën përzgjedhëse, marrëdhënien e punës, vlerësimin e rezultateve në punë, formimin vazhdues, disiplinën, lirim dhe shkarkimin nga detyra të ndihmësit ligjor të avokatëve të shtetit, si dhe elementet e tjera që lidhen me ushtrimin e këtij funksioni miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU V

VEPRIMTARIA E AVOKATURËS SË SHTETIT DHE MARRËDHËNIET NDËRINSTITUCIONALE

Neni 13

Fillimi i gjykimit për pavlefshmëri të veprimeve juridike ose të kontratave administrative

1. Avokatura e Shtetit, sipas kërkesës së motivuar të organit përgjegjës të institucionit të interesuar, ka të drejtë të fillojë procedurat për ngritjen e padisë, me objekt për pavlefshmëri të veprimit juridik, që tjetëron ose disponon pasurinë shtetërore, në favor të të tretëve, ose për pavlefshmëri të kontratave administrative, të lidhura me të tretë.

2. Avokatura e Shtetit, përpara se të depozitojë padinë në gjykatë, i paraqet organit të interesuar një raport të hollësishëm për gjendjen e fakteve dhe të ligjit, kostot e pritshme të gjykimit, si dhe për çdo shpenzim të zakonshëm/të jashtëzakonshëm apo çdo dëmshpërblim pasuror/jopasuror, që pala tjetër mund të pretendojë ose të fitojë gjatë apo pas përfundimit të gjykimit për shpalljen e pavlefshme të kontratës ose të veprimit juridik. Në këtë raport, Avokatura e Shtetit është e detyruar të shprehë qëndrimin për ngritjen ose jo të padisë.

3. Organi i interesuar, pasi njihet me raportin e Avokaturës së Shtetit, të hartuar sipas pikës 2 të këtij neni, jep pëlqimin për ngritjen ose jo të padisë.

Neni 14

Mbrojtja e interesave pasurorë të shtetit në gjykimin penal

(Ndryshuar shifra në pikën 3 me ligjin nr. 86/2018, datë 22.11.2018)

1. Drejtuesi i prokurorisë së rrethit gjyqësor njofton Avokaturën e Shtetit brenda 7 ditëve nga data e regjistrimit të procedimit penal për vepra penale, nga të cilat ka dyshime se janë cenuar interesat pasurorë të institucioneve shtetërore ose të personave juridikë publikë.

2. Avokatura e Shtetit ngre padi civile në procesin penal për kërkimin e pasurisë ose shpërblimin e dëmit, që u është shkaktuar interesave të shtetit nga kryerja e veprës penale.

3. Avokatura e Shtetit mund t'ia delegojë të drejtën e parashikuar në pikën 2 të këtij neni organit qendror ose vendor të administratës, që ka interes të drejtpërdrejtë, ose organit epror të personit juridik publik, në rast se vlera e dëmit është më pak se 2 milionë lekë. Delegimi është i vlefshëm për gjykimin në shkallë të parë dhe në gjykatën e apelit.

Neni 15

Këshillimi

(Ndryshuar pikat 3, 4, ndryshuar fjalë në pikat 7, 8 dhe 9 me ligjin nr. 86/2018, datë 22.11.2018)

1. Avokatura e Shtetit, në mbrojtje të të drejtave dhe të interesave të shtetit, u jep mendim me shkrim organeve të administratës publike, kur kjo i kërkohet prej tyre, në veçanti, për të vënë në lëvizje, për të kundërshtuar ose për të tërhequr çështje në gjykim.

2. Funksioni këshillimor i Avokaturës së Shtetit ka karakter këshillues për institucionet kërkuese dhe ka të bëjë me dhënien e mendimeve, të formuluar në bazë të një analize të mirëfilltë juridike të çështjes, objekt këshillimi dhe të pasojave juridike, që ato mund të sjellin. Në asnjë rast, këshillimi nuk mund të jetë vlerësim mbi qëllimin e nxjerrjes së aktit juridik.

3. Avokatura e Shtetit, kur i kërkohet, jep paraprakisht mendim për projektet e kontratave, të cilat do të nënshkruhen nga ana e personave juridikë, të përcaktuar në nenin 5, të këtij ligji, si dhe mund të sugjerojë paraprakisht përmbajtjen e tyre.

4. Këshillimi paraprak i organit përkatës të administratës publike me Avokaturën e Shtetit është i detyrueshëm për t'u kërkuar, në rastet e mëposhtme:

a) për hartimin, negocimin nënshkrimin, ndryshimin dhe zgjidhjen e kontratave të koncesionit, të kontratave të partneritetit publik-privat. Për kontrata të tjera publike për kryerje punimesh, furnizim mallrash dhe furnizim shërbimesh, me vlerë mbi kufirin e ulët monetar, të përcaktuar në legjislacionin në fuqi për prokurimet publike;

b) për hartimin, negocimin, nënshkrimin, ndryshimin dhe zgjidhjen e kontratave, të cilat parashikojnë zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në arbitrazh ndërkombëtar;

c) kur shfaqen pretendime nga pala private apo institucioni publik në lidhje me përmbushjen e detyrimeve të kontratës, në rast konflikti interpretimesh apo çdo mosmarrëveshje tjetër në ekzekutimin e kontratave që parashikojnë zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në arbitrazh ndërkombëtar;

ç) kur shfaqen pretendime nga investitorë të huaj për shkelje nga Republika e Shqipërisë të ligjit, traktateve apo marrëveshjeve ndërkombëtare për mbrojtjen e investimeve të huaja.

5. Këshillimi i dhënë nga Avokatura e Shtetit institucioneve shtetërore dhe enteve

publike, sipas këtij neni, nuk ka karakter detyrues për to, përveç rasteve kur parashikohet si i tillë me ligj.

6. Avokatura e Shtetit bën sugjerime për procedimet administrative, me natyrë konfliktuale, të cilat mund të bëhen shkak për lindjen e konflikteve gjyqësore.

7. Kryeministri mund ta ngarkojë Avokaturën e Shtetit të japë mendim për projektaktet, që lidhen me veprimtarinë e organeve të administratës publike.

8. Asnjë person juridik, i përcaktuar në nenin 5 të këtij ligji nuk mund të kërkojë drejtpërdrejt ndihmë juridike nga avokatë në profesion të lirë, me përjashtim të rasteve të veçanta, sipas rregullave që do të vendosen nga Këshilli i Ministrave.

9. Mendimi këshillimor, i dhënë nga Avokatura e Shtetit, sipas dispozitave të këtij ligji, jepet në çdo rast me shkrim, është konfidencial dhe është pjesë përbërëse e praktikës, për të cilën kërkohet këshillimi.

Neni 16

Marrëdhëniet e Avokaturës së Shtetit me institucionet shtetërore

(Hiqen fjalë në pikën 3 dhe ndryshohen në pikën 4 me ligjin nr. 86/2018, datë 22.11.2018)

1. Organet e administratës publike detyrohen t'i japin Avokaturës së Shtetit të gjitha sqarimet, informacionet dhe dokumentet e nevojshme, që lidhen me procesin gjyqësor apo këshillimor, brenda 5 ditëve nga data e depozitimit të kërkesës pranë këtyre institucioneve.

2. Marrëdhëniet ndërmjet Avokaturës së Shtetit dhe ministrive realizohen nëpërmjet avokatëve të shtetit, të emëruar pranë këtyre ministrive, sipas kritereve dhe procedurave të parashikuara në dispozitat e këtij ligji.

3. Në rast se nga organet e administratës publike nuk respektohet parashikimi i mësipërm, Avokatura e Shtetit njofton Kryeministrin.

4. Gjatë ushtrimit të funksioneve të parashikuara me ligj, Avokatura e Shtetit merr parasysh udhëzimet e dhëna, në çdo rast me shkrim, nga personi juridik, i përcaktuar në nenin 5 të këtij ligji, përveç rasteve kur ato bien ndesh me legjislacionin në fuqi ose interesin publik.

Neni 17

Ndërmjetësimi dhe pajtimi

(Ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 86/2018, datë 22.11.2018)

1. Avokatura e Shtetit ndërmjetëson për zgjidhjen me pajtim të mosmarrëveshjeve ndërmjet personave juridikë, të përcaktuar në këtë ligj. Zgjidhja, për të cilën është rënë dakord nga palët, pasqyrohet në një projekt marrëveshje dhe përpara nënshkrimit i dërgohet për mendim nga Avokatura e Shtetit ministrisë, në fushën e përgjegjësisë së të cilës përfshihen çështjet e trajtuara nga marrëveshja, dhe ministrisë përgjegjëse për financat, në rastin kur marrëveshja shoqërohet me efekte financiare në buxhetin e shtetit. Ministrinë përgjegjëse duhet të shprehen brenda 30 ditëve nga paraqitja e projekt marrëveshjes.

2. Avokatura e Shtetit rekomandon zgjidhje me pajtim për mosmarrëveshjet ndërmjet një organi qendror ose vendor të administratës publike dhe një organi tjetër qendror ose vendor, kur ata e kërkojnë këtë zgjidhje. Nuk mund të jepen rekomandime për

çështje të mosmarrëveshjeve për kompetencat.

Neni 18

Kontraktimi i shërbimeve të përfaqësimit dhe të konsulencës

(Ndryshuar me ligjin nr. 86/2018, datë 22.11.2018)

1. Në çështje të rëndësishme për interesat e shtetit, ose kur natyra e çështjes kërkon juristë ose ekspertë të specializuar në fusha të veçanta, Avokati i Përgjithshëm i Shtetit kontraktton, sipas një procedure konkurruese dhe transparente përzgjedhjeje, avokatë, studio avokatie ose ekspertë, vendas apo të huaj, si dhe shërbime të tjera ndihmëse.

2. Procedura e kontraktimit nuk i nënshtrohet rregullave për prokurimin publik. Procedurat dhe kriteret për kontraktimin e avokatëve/studiove të avokatisë, ekspertëve apo shërbimeve të tjera ndihmëse, si dhe mënyra e pagesës përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 19

Aksesi i avokatëve të shtetit

(Ndryshuar me ligjin nr. 86/2018, datë 22.11.2018)

1. Avokatura e Shtetit përjashtohet nga detyrimi për pagimin e tarifave gjyqësore, shpenzimeve gjyqësore, si dhe tarifave për veprimet e shërbimet, që kryhen nga organet e administratës publike, administrata gjyqësore, prokuroria dhe shërbimi përmbartimor gjyqësor shtetëror.

2. Shpenzimet gjyqësore apo të noterisë, të nevojshme gjatë dhënies së asistencës juridike, kur nuk plotësojnë kriteret e pikës 1, të këtij neni, paguhen nga personi juridik palë në proces apo organi i interesuar, pas kërkesës së Avokaturës së Shtetit.

3. Avokati i shtetit, me qëllim mbrojtjen e interesave të shtetit, ka akses në dosjet e gjykatave të rretheve gjyqësore, gjykatave të apelit, të Gjykatës së Lartë, Gjykatës Kushtetuese, noterit, apo zyrave të noterive, Arkivin e Shtetit, si dhe në çdo institucion tjetër që mund të ketë dokumentacion dhe informacion të nevojshëm, në përputhje me rregullat dhe procedurat e parashikuara nga legjislacioni i posaçëm. Aksesi në dosjet e gjykatave jepet edhe për verifikimin dhe inspektimin e punës së avokatëve të shtetit.

4. Kur është e nevojshme për mbrojtjen e interesave të shtetit, dëshmia e trashëgimisë, e kërkuar nga Avokatura e Shtetit, lëshohet nga noteri sipas parashikimeve të Kodit Civil dhe legjislacionit në fuqi për noterinë.

KREU V/I

EKZEKUTIMI I VENDIMEVE TË GJYKATËS EVROPIANE

PËR TË DREJTAT E NJERIUT

(Shtuar kreu me ligjin nr. 86/2018, datë 22.11.2018)

Neni 19/1

Ekzekutimi i Vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

1. Vendimet e formës së prerë të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim “GJEDNJ”), për çdo çështje ku Republika e Shqipërisë është palë, janë të detyrueshme për

zbatim dhe ekzekutohen sipas procedurës së parashikuar në këtë ligj.

2. Avokatura e Shtetit, në cilësinë e përfaqësuesit dhe mbrojtësit të interesave pasurorë të shtetit shqiptar pranë GJEDNJ-së, është institucioni kompetent për nisjen e procedurave të ekzekutimit të vendimeve të GJEDNJ-së.

Neni 19/2

Fillimi i procedurave të ekzekutimit

1. Me marrjen dijeni mbi vendimin e formës së prerë, Avokatura e Shtetit, brenda 10 ditëve pune, përcjell vendimin përkatës për përkthim dhe certifikim pranë Ministrisë së Drejtësisë.

2. Ministria e Drejtësisë, brenda 15 ditëve pune nga data e depozitimit të kërkesës së Avokaturës së Shtetit, sipas pikës 1, të këtij neni, dërgon vendimin e përkthyer dhe të certifikuar për publikim në Qendrën e Botimeve Zyrtare, si dhe pranë Avokaturës së Shtetit, me qëllim ndjekjen e procedurave të mëtejshme të ekzekutimit të vendimit të GJEDNJ-së.

3. Një kopje e vendimit origjinal dhe një kopje e përkthyer dhe e certifikuar nga Ministria e Drejtësisë dërgohet nga Avokatura e Shtetit pranë Gjykatës Kushtetuese, Gjykatës së Lartë dhe pranë institucioneve të tjera, për efekt të zbatimit të njësuar të praktikës gjyqësore.

4. Brenda 5 ditëve pune nga dërgimi i vendimit të përkthyer nga Ministria e Drejtësisë, sipas pikës 2, të këtij neni, Avokatura e Shtetit paraqet kërkesën pranë Kryeministrit për propozimin e projektvendimit të Këshillit të Ministrave, në lidhje me ekzekutimin e vendimit të GJEDNJ-së, e cila duhet të përmbajë:

a) institucionet që ngarkohen me ekzekutimin e vendimit, sipas fushës së tyre të përgjegjësisë;

b) llojin e masës që buron nga vendimi i GJEDNJ-së, apo masa të tjera të përshtatshme që duhet të ndërmerren nga autoritetet vendase, në rastet kur vendimi i GJEDNJ-së nuk përcakton në mënyrë të shprehur masat konkrete që duhet të merren nga Republika e Shqipërisë, në kuadër të shkeljeve të konstatuara;

c) mënyrën dhe afatet e ekzekutimit të saj;

ç) sanksionet në rast të mosekzekutimit.

5. Vendimi i Këshillit të Ministrave miratohet brenda 30 ditëve pune nga paraqitja e kërkesës së Avokaturës së Shtetit, sipas pikës 4 të këtij neni.

Neni 19/3

Mbikëqyrja e ekzekutimit

Avokatura e Shtetit është përgjegjëse për koordinimin e procesit të ekzekutimit, hartimin e planeve të veprimit dhe të raporteve, përfaqësimin përpara Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, si dhe monitorimin e procesit të ekzekutimit të vendimeve të GJEDNJ-së nga autoritetet kombëtare. Kur është e nevojshme, Avokatura e Shtetit informon Këshillin e Ministrave në rastet kur konstaton se procesi i ekzekutimit është vështirësuar, apo është ndërprerë dhe mund t'i shkaktohet dëm financiar shtetit.

Neni 19/4

Afatet e ekzekutimit nga institucionet përgjegjëse

Vendimet e GJEDNJ-së që kanë vendosur kompensimin e drejtë, ekzekutohen nga institucionet përkatëse, sipas fushës së tyre të përgjegjësisë, brenda 3 muajve nga momenti kur vendimi i gjykatës merr formën e prerë.

Neni 19/5

Pagesa e dëmeve/kompensimit

1. Detyrimet financiare që burojnë nga vendimet e GJEDNJ-së mbulohen nga buxheti i shtetit, sipas përcaktimeve të parashikuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për ekzekutimin e vendimit të GJEDNJ-së.

2. Përrjashtimisht, për detyrimet financiare deri në 10 000 (dhjetë mijë) euro, pagesa ekzekutohet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga ministria përgjegjëse për financat, pas njoftimit nga Avokatura e Shtetit.

3. Në rast të moskryerjes së pagesës brenda afateve kohore, të parashikuara në nenin 19/4, të këtij ligji, mbi masën e detyrimeve përkatëse financiare paguhet interesi, sipas përcaktimeve në vendimin e GJEDNJ-së.

4. Brenda 10 ditëve pune nga miratimi i vendimit të Këshillit të Ministrave, apo i marrjes së njoftimit nga Avokatura e Shtetit, sipas rastit të parashikuar në pikën 2, të këtij neni, ministria përgjegjëse për financat publikon listën e subjekteve përfituese dhe kërkesën për dorëzimin e dokumentacionit të nevojshëm, për shpërndarjen e fondit përkatës.

5. Në rastet kur pala e interesuar, brenda 30 ditëve pune, nuk dorëzon dokumentacionin e kërkuar, sipas pikës 4, të këtij neni, ministria përgjegjëse për financat transferon pagesën në një llogari të veçantë depozitimi për kërkuesin, e cila qëndron e ngurtësuar derisa të përmbushen procedurat e parashikuara me ligj, por jo më shumë se 6 muaj nga data e depozitimit, me përjashtim të rasteve kur kërkuesi provon se ka një proces gjyqësor ose administrativ të hapur, i cili e pengon në respektimin e këtij afati. Në përfundim të këtij afati, fondet kalojnë në buxhetin e shtetit.

Neni 19/6

Masat shtesë

1. Krahas pagesës së kompensimit, mund të merren masa shtesë, me qëllim rivendosjen në vend të të drejtave e shkelura. Këto masa përfshijnë veprime, të cilat mund të ndërmerren nga Avokatura e Shtetit së bashku me institucionet përgjegjëse për të rikthyer, sa më shumë të jetë e mundur, statusin që mbante kërkuesi përpara cenimit të të drejtave të tij/saj (*restitutio in integrum*).

2. Institucionet përgjegjëse për ekzekutimin e vendimit të GJEDNJ-së, jo më vonë se një muaj nga momenti kur ngarkohen për ekzekutimin e vendimit të gjykatës, njoftojnë Avokaturën e Shtetit, lidhur me faktin nëse:

- a) ekzekutimi do të kryhet brenda afateve ligjore;
- b) procesi i ekzekutimit është bllokuar, duke shpjeguar arsyet, si dhe duke marrë masa institucionale për ekzekutimin e vendimit;
- c) procesi i ekzekutimit nuk ka filluar ose nuk mund të fillojë, duke sqaruar arsyet përkatëse.

Neni 19/7

Llojet e masave të përgjithshme

1. Avokatura e Shtetit ka të drejtën të sugjerojë masa të përgjithshme parandaluese, në lidhje me ndryshimet e nevojshme të legjislacionit apo praktikave, të cilat mund të shkaktojnë dëm financiar për shtetin, si rezultat i shkeljes së Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, të cilat përfshijnë:

- a) ndryshime në legjislacionin në fuqi apo praktikën e zbatimit të tij;
- b) ndryshime në praktikën administrative;
- c) propozime, të cilat duhet të merren në konsideratë gjatë hartimit të ligjeve;
- ç) trajnime profesionale për Konventën dhe praktikën gjyqësore të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut për profesionistët në fushën e ligjit;
- d) masa të tjera të përshtatshme, në përputhje me sugjerimet e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës;
- dh) institucionet përgjegjëse për zbatimin e masave.

2. Institucionet përgjegjëse për zbatimin e masave, sipas pikës 1, të këtij neni, në çdo rast detyrohen të njoftojnë Avokaturën e Shtetit, lidhur me marrjen në konsideratë të sugjerimeve të saj dhe arsyet përkatëse mbi mënyrën e zbatimit të tyre.

Neni 19/8

Këshilli Konsultativ për Çështjet e GJEDNJ-së

1. Avokatura e Shtetit, në kuadër të përmbushjes së detyrimeve, sipas nenit 19/7, të këtij ligji, konsultohet me Këshillin Konsultativ për Çështjet e GJEDNJ-së.

2. Këshilli Konsultativ ushtron veprimtarinë e tij nën drejtimin dhe bashkërendimin e Avokaturës së Shtetit, për sa i përket:

- a) gjetjes së një zgjidhjeje miqësore ndërmjet palëve, që ka për qëllim t'i japë fund çështjes;
- b) shqyrtimit të të gjitha materialeve/ dokumenteve që disponojnë organet shtetërore, në lidhje me çështjen e shqyrtuar nga GJEDNJ;
- c) përcaktimit të një plani pune/veprimi me afate konkrete për realizimin e detyrave konkrete, në kuadër të ekzekutimit të një vendimi;
- ç) paraqitjes së rekomandimeve/zgjidhjeve të mundshme, në kuadër të planit të punës/veprimit;
- d) komunikimeve për informimin e publikut dhe mediave, në lidhje me ekzekutimin e vendimit.

3. Këshilli Konsultativ përbëhet nga 5 anëtarë të emëruar nga Kryeministri, me propozim të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, ndërmjet juristëve me përvojë dhe të njohur në ushtrimin e funksioneve e veprimtarive profesionale juridike.

4. Anëtarët e Këshillit Konsultativ për Çështjet e GJEDNJ-së ushtrojnë këtë funksion për një periudhë 2-vjeçare me të drejtë riemërimi.

5. Përbërja, mënyra e funksionimit, detyrat, afatet dhe shpërblimi përcaktohen me urdhër të Kryeministrit. Në varësi të natyrës së çështjes dhe nevojave që lindin, në përbërje të këtij organi mund të caktohen dhe ekspertë të pavarur, shpërblimi të cilëve bëhet sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 19/9
Marrëdhëniet me Kuvendin

Avokati i Përgjithshëm i Shtetit paraqet raport të paktën një herë në vit përpara Komisionit të Përhershëm për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, mbi ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe masat e ndërmarra në këtë drejtim.

Neni 19/10
Përgjegjësia për mosekzekutimin ose ekzekutimin e papërshtatshëm të vendimeve

Mosmarrja e masave për ekzekutimin e vendimeve të GJEDNJ-së ose ekzekutimi i tyre jo në përputhje me parashikimet e këtij ligji, nga zyrtarët e ngarkuar për kryerjen e tyre, përbën shkak për fillimin e ecurisë disiplinore, sipas legjislacionit në fuqi.

KREU VI
EMËRIMI DHE LARGIMI NGA DETYRA

Neni 20
Kushtet për t'u emëruar avokat i shtetit
(Ndryshuar me ligjin nr. 86/2018, datë 22.11.2018; shtuar paragrafë në shkronjën “c” të pikës 1 dhe pikat 1/1 dhe 1/2 me ligjin nr. 85/2026, datë 23.7.2026)

1. Avokat i shtetit mund të emërohet çdo person që plotëson kushtet e mëposhtme:
 - a) të jetë shtetas shqiptar;
 - b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
 - c) të ketë përfunduar programin e formimit fillestar për avokat shteti pranë Shkollës së Magjistraturës ose plotëson një nga kriteret e mëposhtme:
 - i. zotëron përvojë pune mbi 7 vjet si ndihmës ligjor i avokatit të shtetit në Avokaturën e Shtetit;
 - ii. zotëron përvojë pune mbi 10 vjet si avokat, profesor, lektor i së drejtës ose ka ushtruar mbi 10 vjet profesionin e juristit në një nga institucionet qendrore të administratës publike.
 - ç) të mos jetë i dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë, për kryerjen e një vepre penale;
 - d) të mos jetë shkarkuar nga shërbimi civil, apo çdo funksion tjetër publik, për shkelje ose paaftësi në kryerjen e detyrave;
 - dh) të gëzojë integritet moral dhe profesional.
- 1/1. Emërimi i avokatëve të shtetit, sipas nënndarjeve “i” dhe “ii”, të shkronjës “c”, të pikës 1 të këtij neni nuk mund të jetë më shumë se 50% e vendeve vakante të përvitshme, numri total i të cilave përcaktohet çdo datë 31 të muajit janar nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit.
- 1/2. Përfundimisht, nëse gjatë të njëjtit vit kalendarik nuk plotësohen vendet vakante të mbetura, nëpërmjet provimit të pranimit në programin e formimit fillestar të Shkollës së Magjistraturës këto vende vakante plotësohen, sipas përcaktimeve të

nënndarjeve “i” dhe “ii”, të shkronjës “c”, të pikës 1 të këtij neni, nëpërmjet procedurës përzgjedhëse, sipas rregullave të hollësishme të miratuara me urdhër të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, bazuar në parimet e shanseve të barabarta, meritës dhe profesionalizmit.

2. Rregulla më të hollësishme lidhur me konkurrimin, formimin fillestar, formimin vazhdues, stazhin profesional, numrin e të trajnuarve, kurset e trajnimit, fondet përkatëse, përcaktohen në një marrëveshje midis Shkollës së Magjistraturës dhe Avokaturës së Shtetit.

Neni 21

Emërimi

(Ndryshuar me ligjin nr. 86/2018, datë 22.11.2018)

1. Avokati i Përgjithshëm i Shtetit emërohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të Kryeministrit, nga radhët e juristëve të shquar që kanë të paktën 10 vjet përvojë në profesion.

2. Avokati i shtetit emërohet nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit, në përputhje me kushtet, kriteret dhe procedurat e parashikuara në këtë ligj.

3. Drejtuesit e strukturave të Avokaturës së Shtetit, në të dyja nivelet, emërohen nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit, nga radhët e avokatëve të shtetit.

Neni 22

Zëvendësimi

(Ndryshuar fjalë në pikën 1 dhe hequr fjalë në pikën 2 me ligjin nr. 86/2018, datë 22.11.2018)

1. Avokati i Përgjithshëm i Shtetit zëvendësohet në detyrë, në mungesë dhe me porosi të tij, nga njëri prej avokatëve të shtetit në nivel qendror.

2. Në rastet kur vendi i Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit mbetet vakant, me urdhër të Kryeministrit, mund të emërohet, përkohësisht, deri në emërimin e Avokatit të ri të Përgjithshëm të Shtetit, njëri prej avokatëve të shtetit në detyrë pranë Avokaturës së Shtetit në nivel qendror.

Neni 23

Papajtueshmëria

(Shtuar fjalë në fund të nenit me ligjin nr. 86/2018, datë 22.11.2018)

Avokati i Shtetit nuk mund të kryejë funksione të tjera, publike apo private, të cilat bien ndesh me detyrat funksionale, të përcaktuara në këtë ligj me përjashtim të veprimtarive akademike e të mësimdhënies.

Neni 24

Konflikti i interesave

(Shfuqizuar pika 2 me ligjin nr. 86/2018, datë 22.11.2018)

1. Avokati i Përgjithshëm i Shtetit, si dhe çdo avokat i shtetit nuk mund të përfaqësojnë shtetin, në rast se ka interesa, të njohura ose jo publikisht, për çështjen në gjykim, sipas dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative dhe legjislacionit në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike.

2. Shfuqizuar.

Neni 25

Vlerësimi i aftësive profesionale

1. Avokatët e shtetit, në përfundim të çdo viti kalendarik, i nënshtrohen një procedure vlerësimi të aftësive profesionale nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit, duke pasur parasysh edhe rezultatet e arritura në proceset gjyqësore, që kanë përfaqësuar gjatë periudhës së vlerësimit.

2. Kriteret, rregullat dhe procedurat e vlerësimit përcaktohen në rregulloren e brendshme të funksionimit të Avokaturës së Shtetit.

3. Vlerësimi për paaftësi profesionale përbën shkak për fillimin e procedurës për shkarkimin nga detyra të avokatit të shtetit.

Neni 26

Lirimi dhe shkarkimi nga detyra

(Ndryshuar pikat 3 dhe 4 dhe shtuar pikat 5 dhe 6 me ligjin nr. 86/2018, datë 22.11.2018)

1. Avokatët e shtetit lirohen nga detyra kur:

a) japin dorëheqjen;

b) mbushin moshën e pensionit;

c) mungojnë në detyrë për një periudhë kohore më të gjatë se 3 muaj;

ç) u është hequr zotësia për të vepruar me vendim gjykate të formës së prerë.

2. Avokatët e shtetit shkarkohen nga detyra vetëm në rastet kur:

a) vërtetohet paaftësia profesionale;

b) merret ndaj tyre masa disiplinore e shkarkimit nga detyra, sipas kriterëve dhe procedurave të parashikuara në nenin 31 të këtij ligji;

c) dënohen me vendim gjykate të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale.

3. Lirimi ose shkarkimi nga detyra i avokatit të shtetit dhe i drejtuesit të strukturave të Avokaturës së Shtetit bëhet me urdhër të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit.

4. Avokati i Përgjithshëm i Shtetit lirohet ose shkarkohet nga detyra me propozim të Kryeministrit dhe me vendim të Këshillit të Ministrave.

5. Avokati i Përgjithshëm i Shtetit lirohet nga detyra kur:

a) jep dorëheqjen;

b) mbush moshën e pensionit;

c) mungon në detyrë për një periudhë kohore më të gjatë se 3 muaj;

ç) i është hequr zotësia për të vepruar me vendim gjykate të formës së prerë.

6. Avokati i Përgjithshëm i Shtetit shkarkohet nga detyra, nëse vërtetohet se ka kryer një ose disa prej shkeljeve të mëposhtme profesionale dhe etike:

a) neglizhencë të rëndë në ushtrimin e detyrave;

b) mosrespektim haptazi të ligjit në ushtrimin e detyrave, si pasojë e neglizhencës së rëndë dhe të pajustificuar;

- c) neglizhencë të rëndë në drejtimin e institucionit të Avokaturës së Përgjithshme të Shtetit dhe në mbikëqyrjen e veprimtarisë së avokatëve të shtetit;
- ç) kryerjen e një veprimtarie, që konsiderohet me ligj e papajtueshme me funksionin;
- d) kryerjen e sjelljeve që diskreditojnë rëndë figurën e avokatit të shtetit dhe dinjitetin e institucionit;
- dh) nëse është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi.

KREU VI/I
TË DREJTAT DHE PRIVILEGJET E AVOKATIT TË SHETITIT
(Shtuar me ligjin nr. 86/2018, datë 22.11.2018)

Neni 26/1
Statusi i avokatit të shtetit

1. Avokatët e shtetit, të emëruar sipas përcaktimeve të nenit 21, të këtij ligji, gëzojnë statusin e avokatit të shtetit.
2. Statusi i avokatit të shtetit, për qëllim të këtij ligji, përbëhet nga të drejtat dhe privilegjet e avokatit të shtetit.

Neni 26/2
Ruajtja e statusit të avokatit të shtetit

1. Avokatët e shtetit nuk e humbasin statusin e avokatit të shtetit, në rastet kur:
 - a) me kërkesën e tyre dhe me miratim të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit shërbejnë për një afat deri në tre vjet në strukturat juridiko-profesionale të Kryeministrit, Ministrit të Drejtësisë, të administratës së Këshillit të Lartë Gjyqësor, të Gjykatës Kushtetuese ose Gjykatës së Lartë, pedagogë ose drejtor në Shkollën e Magjistraturës. Trajtimi financiar i avokatit të shtetit, gjatë kësaj periudhe, bëhet nga institucionet përkatëse, sipas pagës për pozicionin e punës;
 - b) me kërkesë dhe me miratim të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, i nënshtrohen studimeve apo trajnimeve të posaçme, për periudha jo më të gjata se një vit. Gjatë periudhës së pezullimit për këtë shkak, avokatët e shtetit nuk paguhen.
2. Në përfundim të afatit të përcaktuar në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 1, të këtij neni, avokatët e shtetit, me kërkesë të tyre, kanë të drejtë të kthehen në pozicionin e mëparshëm të punës, ose, në rast se pozicioni i mëparshëm është i plotësuar përfundimisht, në një pozicion tjetër të të njëjtin nivel.
3. Avokatët e shtetit, që në përfundim të afateve të parashikuara në pikën 1, të këtij neni, nuk kanë kërkuar të kthehen, e humbasin statusin që gëzojnë. Në rast se kërkojnë rikthimin pranë Avokaturës së Shtetit pas kalimit të këtij afati, ata i nënshtrohen sërish kërkesave për praninë në institucion, sipas parashikimeve të këtij ligji.
4. Periudha e përcaktuar në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 1, të këtij neni, llogaritet si periudhë vjetërsie në profesion si avokat shteti, për efekt të pagës dhe të karrierës profesionale.
5. Avokatët e shtetit nuk e humbasin titullin “Avokat shteti” në rastet e dorëheqjes dhe kanë të drejtë të rikthehen përsëri në strukturat e Avokaturës së Shtetit, sipas procedurave të pikës 3 të këtij neni.

Neni 26/3
**Ngritja në detyrë, ulja
në detyrë dhe transferimi**

1. Çdo avokat shteti, me kërkesë me shkrim, mund të kërkojë ngritje në detyrë për t'u emëruar në nivel qendror, ose drejtues zyre, në rast se plotëson kushtet e mëposhtme:

a) ka ushtruar detyrën avokat shteti në nivel vendor për një afat jo më të shkurtër se pesë vjet;

b) puna e tij gjatë pesë viteve të fundit është vlerësuar jo më pak se tre herë në nivelin "Shumë mirë" dhe herët e tjera jo më ulët se niveli "Mirë".

2. Për avokatët e shtetit që mbajnë gradën shkencore "Doktor i shkencave në fushën juridike", kriteri i kërkuar në shkronjën "a", të pikës 1, të këtij neni, bëhet tre vjet.

3. Kur për çdo vend vakant konkurrojnë dy apo më shumë kandidatë, Avokati i Përgjithshëm, mbi bazën e treguesve të secilit kandidat, si edhe duke pasur parasysh përvojën në punë, emëron avokatin më të përshtatshëm.

4. Avokati i Përgjithshëm i Shtetit, për nevoja pune që kanë të bëjnë me pamjaftueshmërinë në staf apo mbingarkesën në punë, mund të transferojë përkohësisht një ose më shumë avokatë shteti të nivelit qendror ose vendor, brenda të njëjtit nivel, ose në një nivel më të ulët, edhe pa pëlqimin e tyre, për një periudhë deri në gjashtë muaj. Gjatë periudhës së transferimit, avokatët e shtetit vazhdojnë të paguhen dhe të përfitojnë shpërblimet sipas nivelit në të cilin bëjnë pjesë. Me mbarimin e kësaj periudhe, avokati i shtetit kthehet në pozicionin që ka pasur përpara transferimit.

Neni 26/4
Ngritja profesionale

1. Avokatët e shtetit ndjekin programet e formimit vazhdues pranë Shkollës së Magjistraturës.

2. Avokatët e shtetit, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, përfitojnë falas Fletoren Zyrtare dhe revista juridike.

Neni 26/5
Dokumenti i identifikimit

Avokati i shtetit pajiset me dokument identifikimi. Forma dhe përmbajtja e dokumentit përcaktohen me urdhër të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit.

Neni 26/6
Ruajtja e të dhënave

Avokatëve të shtetit u ndalohet të bëjnë publike ose t'u japin personave të tretë të dhëna që mund të dëmtojnë çështjen në proces gjykimi ose këshillimi, si dhe të dhëna me karakter konfidencial ose të rezervuar.

Neni 26/7
Koha e punës

1. Koha javore e punës dhe orari, si rregull, janë të njëjta me ato të punonjësve të administratës publike.

2. Në rast nevoje, me urdhër të eprorit të drejtpërdrejtë, avokati i shtetit është i detyruar të punojë edhe jashtë orarit, në ditët e pushimit javor, të festave zyrtare ose kur është duke kryer lejen vjetore.

3. Avokati i shtetit, që kryen detyra të ngutshme në ditët e pushimit javor ose të festave zyrtare, përfiton shtesë në pagë, në masën 50 për qind të pagës së tij ditore.

Neni 26/8
Leja vjetore

Avokati i shtetit gëzon të drejtën e një lejeje vjetore të pagueshme prej 30 ditësh kalendarike.

Neni 26/9
Leja për raste të veçanta

Për nevoja të veçanta, vetjake ose familjare, avokati i shtetit ka të drejtë të përfitojë leje të papaguar deri 20 ditë në muaj, por jo më tepër se 30 ditë në vit.

KREU VII
PAGA DHE SHPËRBLIMI

Neni 27
Paga, shpërblimet dhe trajtimet

(Ndryshuar me ligjin nr. 86/2018, datë 22.11.2018; shtuar pika 4/1 me ligjin nr. 85/2026, datë 23.7.2026)

1. Paga e Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit është në raportin 0,95 të pagës së Kryeministrit.

2. Paga e avokatit të shtetit në nivel qendror është në raportin 0,78 të pagës së Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit.

3. Paga e kryetarëve të zyrave vendore është në raportin 0,70 të pagës së Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit.

4. Paga e avokatëve të shtetit në nivel vendor është në raportin 0,64 të pagës së Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit.

4/1. Paga e ndihmësit ligjor të avokatit të shtetit është sa 0,45% e pagës së Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit.

5. Pagat e nëpunësve/punonjësve të tjerë përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

6. Kandidatët për avokat shteti që ndjekin programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, trajtohen me bursë shkollimi ose shpërblim deri në 50 përqind të pagës së avokatit të shtetit në nivel vendor. Fondet e nevojshme përballohen nga buxheti i Shkollës së Magjistraturës.

Neni 28

**Krijimi i fondit dhe shpërblimi
i avokatëve të shtetit**

(Ndryshuar me ligjin nr. 86/2018, datë 22.11.2018, hequr fjalë në pikën 2 me ligjin nr. 91/2023, datë 2.11.2023)

1. Avokati i shtetit përfiton shpërblim të posaçëm për çështje gjyqësore të veçanta, të vështira dhe me interes të madh ekonomik e financiar për Republikën e Shqipërisë. Ky shpërblim përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit.

2. Klasifikimi i çështjeve, kriteret, mënyra dhe procedurat e dhënies së këtij shpërblimi përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU VIII

PËRGJEGJËSIA DHE MASAT DISIPLINORE

Neni 29

Përgjegjësia disiplinore

1. Avokati i shtetit i nënshtrohet përgjegjësisë disiplinore, sipas parashikimeve të këtij ligji.

2. Avokati i shtetit ka përgjegjësi disiplinore për shkelje të ligjit dhe për kryerjen e akteve e të sjelljeve, që diskreditojnë pozitën dhe figurën e tij, në përputhje me parashikimet e nenit 30 të këtij ligji.

Neni 30

Shkeljet disiplinore

(Ndryshuar shkronja “a” e pikës 3, shtuar shkronja ”e” në pikën 3 me ligjin nr. 91/2023, datë 2.11.2023)

1. Shkeljet disiplinore ndahen në:

- a) të lehta;
- b) të rënda;
- c) shumë të rënda.

2. Janë shkelje të lehta aktet dhe sjelljet si më poshtë:

a) veprimet dhe mosveprimet e avokatit të shtetit, të cilat passjellin zvarritje të proceseve gjyqësore;

b) mungesa e pajustificuar në punë deri në 3 ditë;

c) akte dhe sjellje të tjera, që diskreditojnë pozitën dhe figurën e avokatit të shtetit.

3. Janë shkelje të rënda aktet dhe sjelljet si më poshtë:

a) zvarritja e pajustificuar e veprimeve të avokatit të shtetit gjatë ushtrimit të funksioneve të parashikuara me ligj, kur ka passjellë ose mund të sillte pasoja për interesat pasurore të shtetit;

b) braktisja e punës ose mungesa e pajustificuar dhe e vijueshme për më shumë se 3 ditë, në rastet kur ky veprim ka sjellë ose mund të sillte pasoja të rënda për interesat

pasurorë të shtetit;

c) bërja publike e akteve ose e dokumenteve zyrtare, e të dhënave apo regjistrimeve me karakter sekret ose konfidencial;

ç) pengimi i inspektimeve të kryera sipas dispozitave ligjore dhe nënligjore në fuqi;

d) thyerja e disiplinës në punë, në mënyrë të përsëritur dhe pas paralajmërimit të dhënë me shkrim nga eprori;

dh) humbja e çështjes gjyqësore, si rezultat i nivelit të dobët të përfaqësimit në proces;

e) moskryerja e detyrave funksionale të përcaktuara në këtë ligj.

4. Janë shkelje shumë të rënda aktet dhe sjelljet si më poshtë:

a) rastet, kur provohet se avokati i shtetit ka përdorur funksionin e tij në shërbim të interesave vetjakë apo të personave, me të cilët ka lidhje familjare;

b) rastet kur provohet se avokati i shtetit, me veprimet ose mosveprimet e tij, ka krijuar favore për persona të tjerë, në dëm të interesave të shtetit;

c) rastet kur avokati i shtetit shkel dispozitat e këtij ligji dhe të kodit të etikës, të miratuar nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit;

ç) rastet kur avokati i shtetit ka këshilluar në kundërshtim me interesat e institucionit qendror, që ka kërkuar konsulencën;

d) rastet kur provohet se ka shkelur urdhrat dhe udhëzimet e nxjerra nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit;

dh) rastet kur avokati i shtetit kryen vepra penale, që lidhen me ushtrimin e detyrës;

e) akte dhe sjellje të tjera, që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e avokatit të shtetit.

Neni 31

Masat disiplinore

(Shtuar pika 2.1 me ligjin nr. 91/2023, datë 2.11.2023)

1. Masat disiplinore për avokatët e shtetit, në të dyja nivelet, jepen nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit, sipas një procedure disiplinore, e cila garanton të drejtën për t'u informuar, për t'u dëgjuar, për t'u mbrojtur dhe për t'u ankuar.

2. Për çdo shkelje jepet vetëm një masë disiplinore. Masa disiplinore jepet në përputhje të drejtë me shkeljen e kryer.

2.1 Për përcaktimin e masës disiplinore të zbatueshme merren parasysh:

a) shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e ardhura prej saj;

b) shkalla e fajësisë;

c) ekzistenca e masave të tjera disiplinore të mëparshme.

3. Llojet e masave disiplinore janë:

a) vërejtje me shkrim;

b) vërejtje me paralajmërim;

c) shkarkim nga detyra.

4. Kur provohet, sipas dispozitave të këtij ligji, se avokati i shtetit ka kryer të paktën një rënë nga shkeljet e parashikuara në pikën 4 të nenit 30 të këtij ligji, jepet masa disiplinore e parashikuar në shkronjën “c” të pikës 3 të këtij neni.

5. Masat e mësipërme disiplinore mund të shlyhen nëse, brenda 1 viti nga data e dhënies së masës “vërejtje me shkrim” dhe brenda 2 vjetëve nga data e dhënies së masës

“vërejtje me paralajmërim”, ndaj avokatit të shtetit nuk është marrë ndonjë masë tjetër disiplinore. Masat disiplinore të shlyera hiqen nga dosja vetjake.

Neni 32

Procedimi disiplinor

(Shtuar fjalë në fund të pikës 1 me ligjin nr. 86/2018, datë 22.11.2018)

1. Të drejtën për nisjen e procedimit disiplinor ndaj avokatit të shtetit e ka Avokati i Përgjithshëm i Shtetit në përputhje me rregulloren e brendshme të Avokaturës së Shtetit.
2. Fillimi i procedimit disiplinor mund të bëhet jo më vonë se 1 vit nga data e konstatimit të shkeljes, por jo më vonë se 5 vjet nga data e kryerjes së saj.

Neni 32/1

Komisioni i disiplinës

(Shtuar me ligjin nr. 86/2018, datë 22.11.2018)

1. Komisioni i disiplinës është organi kompetent që shqyrton procedimin disiplinor ndaj avokatëve të shtetit.
2. Komisioni i disiplinës përbëhet nga kryetarët e zyrave në nivel qendror, me përjashtim të Zyrës së Inspektimit dhe drejtohet nga Kryetari i Zyrës së Përfaqësimit në Gjykatat Kombëtare.
3. Komisioni i disiplinës, brenda dhjetë ditëve pune nga dita e paraqitjes së kërkesës së Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, fillon procedimin disiplinor dhe njofton avokatin e shtetit që ka kryer shkeljen, për t’u paraqitur në seancën dëgjimore.
4. Komisioni i disiplinës, pasi ka përfunduar procedurën e hetimit administrativ, i paraqet Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit raportin përfundimtar, së bashku me propozimin për masën disiplinore.
5. Avokati i Përgjithshëm i Shtetit, brenda 5 ditëve pune nga data e paraqitjes së raportit përfundimtar dhe propozimit për masën disiplinore, merr një nga masat disiplinore, të parashikuara në nenin 31 të këtij ligji.
6. Rregulla të hollësishme për mënyrën e organizimit, funksionimit dhe garantimin e të drejtave të avokatëve të shtetit gjatë procedurës disiplinore përcaktohen në rregulloren e brendshme të funksionimit të Avokaturës së Shtetit.

Neni 32/2

Pezullimi i avokatit të shtetit

(Shtuar neni me ligjin nr. 91/2023, datë 2.11.2023)

1. Nëse ka prova që vërtetojnë se vazhdimi i ushtrimit të detyrës nga avokatit i shtetit, ndaj të cilit ka filluar një procedim disiplinor, pengon hetimin administrativ apo mund të cenojë ushtrimin e përshtatshëm të detyrës së tij, Komisioni i Disiplinës vendos pezullimin e avokatit të shtetit ose merr çdo masë tjetër të përshtatshme deri në marrjen e vendimit përfundimtar.
2. Pezullimi zgjat deri në marrjen e vendimit përfundimtar, por, në çdo rast, jo më shumë se 3 (tre) muaj.
3. Avokati i Shtetit përfiton 50% të pagës gjatë periudhës së pezullimit.

4. Në përfundim të procesit disiplinor, në rast se nuk konstatohen shkelje disiplinore të avokatit të shtetit, ky i fundit përfiton diferencën e pagës për periudhën e pezullimit.

Neni 33

Ankimi ndaj masave disiplinore

(Shtuar paragrafi i dytë me ligjin nr. 91/2023, datë 2.11.2023)

Ndaj masës disiplinore të dhënë, avokati i shtetit ka të drejtë të ankohet drejtpërdrejt në gjykatë, sipas legjislacionit në fuqi, për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative.

Për ankimin e paraqitur ndaj masës disiplinore “shkarkim nga detyra”, zgjidhja e pasojave, për aq sa nuk parashikohet nga ky ligj, rregullohet sipas dispozitave të Kodit të Punës.

KREU VIII/1

KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE DHE SANKSIONET

(Shtuar me ligjin nr. 85/2026, datë 23.7.2026)

Neni 33/1

Kundërvajtjet administrative dhe sanksionet

1. Shkeljet e mëposhtme, të kryera nga titullari dhe/ose nga nëpunësi përgjegjës i personit juridik që është palë në një proces gjyqësor, të cilit i ofrohet shërbimi i përfaqësimit nga Avokatura e Shtetit, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë, si më poshtë:

a) mosparaqitja e dokumentacionit, shpjegimeve, informacioneve apo qëndrimit të institucionit, të nevojshme për shqyrtimin e çështjes së Avokaturës së Shtetit, brenda 5 ditëve nga data e depozitimit të kërkesës pranë këtyre institucioneve, kur ky informacion është i domosdoshëm për ushtrimin e funksionit të përfaqësimit apo të mbrojtjes ligjore, nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë;

b) mosdepozitimi ose depozitimi i pasaktë i informacionit dhe akteve procedurale pranë gjykatës gjatë zhvillimit të procesit gjyqësor, nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë;

c) mosparaqitja apo refuzimi i pajustificuar për të marrë pjesë në procesin gjyqësor për të dhënë shpjegime, për të nënshkruar ose për të miratuar qëndrimin institucional, kur kërkohet nga Avokatura e Shtetit, ose kryerja me dashje e veprimeve apo mosveprimeve që pengojnë seriozisht përfaqësimin dhe mbrojtjen ligjore të interesave pasurore shtetërore, nga 500 000 (pesëqind mijë) deri në 1 000 000 (një milion) lekë.

2. Në çdo rast, kur kanë ardhur pasoja për interesat pasurore të shtetit, titullari dhe nëpunësi përgjegjës përgjigjet sipas legjislacionit në fuqi për përgjegjësinë civile. Në këto raste personi juridik ka të drejtë të ngrejë padi regresi në gjykatë.

3. Me nëpunës përgjegjës kuptohet drejtuesi i strukturës që mbulon përfaqësimin në gjykatë apo punonjësi me profil jurist, të ngarkuar me përfaqësimin në gjykatë të institucionit dhe shkëmbimin e informacionit me Avokaturën e Shtetit.

4. Gjjobat vendosen nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit dhe arkëtohen në buxhetin e shtetit.

5. Procedura për vendosjen e gjobës dhe formati tip përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 33/2

Shlyerja e masës së dënimit me gjobë

Shlyerja e masës së dënimit me gjobë bëhet në përputhje me parashikimet e ligjit për kundërvajtjet administrative.

Neni 33/3

Ankimi i sanksioneve administrative

Personi ndaj të cilit është vendosur masë administrative, sipas dispozitave të këtij ligji, ka të drejtë të bëjë ankim në gjykatën administrative të shkallës së parë, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

KREU IX

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 34

Regjimi kalimtar

1. Të gjitha praktikat dhe proceset në trajtim nga Avokatura e Shtetit, të nisura përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, trajtohen sipas dispozitave të ligjit në fuqi, në kohën e nisjes së tyre.

2. Deri në miratimin e rregullores së brendshme të funksionimit të Avokaturës së Shtetit, zyrat në nivel qendror dhe vendor të Avokaturës së Shtetit ushtrojnë të gjitha kompetencat e parashikuara në dispozitat e ligjit nr.8551, datë 18.11.1999 “Për Avokaturën e Shtetit”, të ndryshuar.

3. Struktura dhe organika e përfaqësuesit ligjor, e cila funksionon sipas dispozitave të ligjit nr.8456, datë 11.2.1999 “Për funksionet e përfaqësuesit ligjor pranë organizmave ndërkombëtarë për të drejtat e njeriut” pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe fondet buxhetore të dhëna për të integrohen në institucionin e Avokaturës së Shtetit, duke filluar nga data 1 janar 2009.

4. Të gjithë avokatët e shtetit në detyrë do t’i nënshtrohen një provimi teorik. Përfshihen nga ky detyrim të gjithë avokatët e shtetit, të cilët aktualisht gëzojnë statusin e magjistratit, gjyqtarit, prokurorit, si dhe kanë titull shkencor. Personat që nuk e kalojnë me sukses procesin përzgjedhës të posaçëm, do të qëndrojnë përkohësisht në funksionet e tyre, derisa të zëvendësohen nga një avokat i shtetit. Këtyre personave nuk u mohohet e drejta për të marrë pjesë në proceset e zakonshme të përzgjedhjes së Avokatëve të Shtetit, sipas nenit 21 të këtij ligji.

5. Rregullat për organizimin e provimit të parashikuar në pikën 4 të këtij neni përcaktohen në rregulloren e brendshme të funksionimit të Avokaturës së Shtetit, sipas në nenit 4 pika 6 të këtij ligji.

Neni 35
Sanksione
(Shfuqizuar me ligjin nr. 85/2026, datë 23.7.2026)

Neni 36
Aktet nënligjore
(Shtuar togfjalësh në pikën 1 dhe pikën 3 me ligjin nr. 85/2026, datë 23.7.2026)

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 4 pika 7, të nenit 12/1, pika 5, nenit 18 pika 2, nenit 27 dhe nenit 28 dhe nenit 33/1, pika 5 të këtij ligji.

2. Ngarkohet Ministri i Drejtësisë të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 4 pika 6 dhe nenit 7 pika 3 të këtij ligji.

3. Ngarkohet Avokati i Përgjithshëm i Shtetit të nxjerrë aktet e nevojshme në zbatim të nenit 12/1, pika 4, të nenit 20, pika 1/2, dhe të nenit 30 pika 4 shkronja “c” të këtij ligji.

Dispozitë kalimtare
(Shtuar me ligjin nr. 86/2018, datë 22.11.2018)

1. Deri në miratimin e rregullores së brendshme të funksionimit të Avokaturës së Shtetit, me ndryshimet përkatëse, zyrat në nivel qendror dhe vendor të Avokaturës së Shtetit ushtrojnë të gjitha kompetencat e parashikuara në dispozitat e ligjit nr. 10 018, datë 13.11.2008, “Për Avokaturën e Shtetit”.

2. Punonjësit e emëruar në pozicionin e avokatit të shtetit, të cilët nuk gëzojnë statusin e avokatit të shtetit, janë subjekt i vlerësimit profesional. Punonjësit vazhdojnë të ushtrojnë përkohësisht detyrën e avokatit të shtetit, përveç kur marrëdhënia e punës përfundon sipas shkaqeve të përcaktuara në ligj, ose si rezultat i procesit të vlerësimit profesional. Rregulla më të hollësishme mbi vlerësimin profesional, fazat e zhvillimit të tij dhe procedura përcaktohen në rregulloren e brendshme të funksionimit të Avokaturës së Shtetit.

3. Rregullat e parashikuara në pikën 2, të këtij neni, nuk zbatohen për Avokatin e Përgjithshëm të Shtetit, si dhe për avokatët e shtetit, të cilët gëzojnë statusin e avokatit të shtetit në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji. Avokatët e shtetit në detyrë dhe ata që kalojnë fazën e vlerësimit profesional duhet të ndjekin programin e formimit vazhdues, sipas temave, afateve dhe listës së miratuar nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit në marrëveshje me Shkollën e Magjistraturës.

4. Përfundimisht, deri në daljen e grupit të parë të kandidatëve për avokat shteti, të cilët kanë përfunduar programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, apo kur prurjet nga Shkolla e Magjistraturës nuk janë të mjaftueshme për të plotësuar kërkesat e Avokaturës së Shtetit, por jo më vonë se 5 vjet nga hyrja në fuqi e këtij ligji, në mungesë të kandidatëve që plotësojnë kushtin e parashikuar në pikën 1, shkronja “c”, të nenit 20, të këtij ligji, në pozicionin e avokatit të shtetit mund të emërohet edhe kandidati, i cili, përveç kushteve të tjera të parashikuara në pikën 1, të nenit 20, të këtij ligji:

a) ka përfunduar programin e ciklit të dytë të studimeve universitare për drejtësi brenda vendit, ose diplomë të njësuar me të, apo ka përfunduar studimet universitare për drejtësi jashtë

vendit, të njohur dhe njësuar sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë;

b) ka jo më pak se 6 vite përvojë pune në sistemin gjyqësor ose në administratën publike, brenda profilit të detyrës së avokatit të shtetit;

c) kalon me sukses testimin profesional, të organizuar nga Avokatura e Shtetit sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara në rregulloren e brendshme të funksionimit të Avokaturës së Shtetit.

5. Përfshihen nga parashikimi i shkronjës “c”, të pikës 4, të këtij neni, kandidatët që përmbushin njërin prej kushteve të mëposhtme:

a) kanë punuar gjyqtar ose prokuror;

b) zotërojnë eksperiencë pune si jurist prej jo më pak se 10 vjet përvojë profesionale në administratën e Kuvendit, Presidentit, aparatit të Këshillit të Ministrave, ministri dhe institucione qendrore të pavarura, në Gjykatën Kushtetuese dhe Gjykatën e Lartë;

c) zotërojnë eksperiencë pune, si dhe integritet profesional si pedagog pranë Fakultetit të Drejtësisë apo Shkollës së Magjistraturës.

Neni 37 **Shfuqizime**

Ligjet nr.8551, datë 18.11.1999 “Për Avokaturën e Shtetit”, të ndryshuar dhe nr.8456, datë 11.2.1999 “Për funksionin e përfaqësuesit ligjor pranë organizmave ndërkombëtarë për të drejtat e njeriut”, si dhe çdo dispozitë tjetër ligjore, që bie në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, shfuqizohen.

Neni 38 **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi më 1 janar 2009.

Shpallur me dekretin nr.5951, datë 24.11.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi